



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

NR. NR. BY:

31.05.2023

02 / 273



## REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neneve 15 dhe 34, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina dhe për ndryshimin dhe plotësimin Ligji Nr.08/L-071, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011", Statutit të Komunës së Malishevës nr. 01-871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_2023, miratoi këtë:

### RREGULLORE

#### PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E

#### KOMUNËS SË MALISHEVËS

##### Neni 1

##### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kjo rregullore përshkruan përmbajtjen për mënyrën e ofrimit të shërbimit publik, mënyrën e menaxhimit të mbeturinave në lidhje me shërbimin publik të mbledhjes së mbeturinave të përziara, mbeturinave të biodegradueshme komunale dhe mbledhjen e veçantë të mbeturinave të letrës, metalit, qelqit, plastikës, tekstilit, dhe mbeturinat e vëllimshme, përcaktimi i pikave të riciklimit, metoda e llogaritjes së sasisë së mbeturinave të përziara komunale për periudha të caktuara kohore, mënyra dhe kushtet e përcaktimit dhe llogaritjes së tarifës për pagesën e mbeturinave komunale për amvisëri dhe biznese.

##### Neni 2

##### QËLLIMI

1. Kjo rregullore përcakton çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, si dhe përcakton vlerën (shumën) e taksës për mbeturina, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm financiar me cilësi të lartë, dhe ekonomikisht të efektshëm të mbledhjes

së mbeturinave komunale në Komunën e Malishevës, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtja e interesit publik.

2. Me këtë rregullore përcaktohet sistemi, mënyra e mbledhjes, ndarjes, përpunimit, riciklimit të mbeturinave, llojin, numrin e kontejnerëve, mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjen e tyre, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrën e transportimit të tyre.

3. Qëllimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave komunale është që të siguroj mundësinë e përdorimit të shërbimit publik, të mbledhjes së mbeturinave të përziera komunale dhe mbeturinave komunale të biodegradueshme. Gjeneruesit e mbeturinave do të inkurajohen të dorëzojnë mbeturinat ndaras, në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave të përziera komunale dhe ato të biodegradueshme dhe për qëllime të bizneseve të interesuara për ndonjë lloj të këtyre mbeturinave.

4. Rregullorja në përputhje me legjislacionin mjedisor, identifikon qartë përgjegjësitë e secilit subjekt të përfshirë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

### **Neni 3**

#### **FUSHËVEPRIMI**

1. Fushëveprimi i kësaj rregulloreje definon kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave, në minimizimin, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, deponimin, riciklimin dhe taksës për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësorë në juridiksionin e Komunës.

2. Komuna e Malishevës ka qëllim të bashkëpunoj ngushtë me qytetarët me qëllim që të ngrejë vetëdijen, të rris përgjegjshmërinë e qytetarëve për një qytet më të pastër dhe më të shëndetshëm.

## Neni 4

## PËRKUFIZIMET

1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë domethënie:

**1.1. Mbeturinë** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.

**1.2. Menaxhim i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

**1.3. Gjeneruesi i mbeturinave**- subjekt fizik apo juridik i cilësuar si krijuesi i mbeturinave.

**1.4. Operator** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e ligjit kryen shërbimet përkatëse, menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.

**1.5. Leje përkatëse mjedisore** - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjeve në fuqi.

**1.6. Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

**1.7. Konsumatori** – person i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara.

**1.8. Ripërdorimi** - çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë destinuar.

**1.9. Grumbullimi** – grumbullimi dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri të objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.

**1.10. Grumbullimi i ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

**1.11. Krijuesi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

**1.12. Zotëruesi i mbeturinës** - krijuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.

**1.13. Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

**1.14. Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

**1.15. Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.

**1.16. Mbeturina industriale** - mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

**1.17. Mbeturina inerte** - mbeturina të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

a. Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

b. I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

**1.18. Mbeturinë e vëllimshme** - mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

**1.19. Qendrat grumbulluese** – lokacioni për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

**1.20. 3R** – reduktim, ripërdorim, reciklim.

**1.21. Amvisëritë jo rezidente**- personat fizik ose juridik të cilët kanë vendqëndrim në territorin e Komunës së Malishevës më pak se 6 muaj.

#### Neni 5

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS

1. Përgjegjësitë e komunës për menaxhimin e mbeturinave janë:

(1) Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale,

(2) Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar,

(3) Procesi i kontraktimit për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave,

(4) Formimi i sektorit mbi menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike,

(5) Sektori për menaxhimin e mbeturinave, mbikëqyrë dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.

(5.1) Sektori për menaxhimin e mbeturinave mbikëqyrë ,përpunon dhe përditëson bazën e të dhënave të gjeneruesve të mbeturinave në bazë të ligjit NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.( GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 6 / 25 SHKURT 2019, PRISHTINË)

(6) Të bëjë monitorimin mjedisor të deponive që janë në kompetencë komunale.

- (7) Menagjimi i mbeturinave komunale nga konstrukt-demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale dhe të vëllimshme.
- (8) Të identifikoj pikat ilegale ( të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe largimin e tyre,
- (9) Përcaktimi i lokacioneve, numrin dhe llojin e kontejnerëve në bashkëpunim me operatorin ose palët e treta,
- (10) Promovimi për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.),
- (11) Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave,
- (12) Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave,
- (13) Faturimi i taksës mbi mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja,
- (14) Përpilimi i raporteve mbi menaxhimin e mbeturinave:
  - a) Faturimi,
  - b) Shkalla e inkasimit,
  - c) Sasinë e grumbulluar dhe të deponuar të mbeturinave.
- (15) Formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina
- (16) Përcaktimi i taksës dhe mënyra e arkëtimit të mjeteve financiare,
- (17) Dorëzimi i Raportit në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për SMM çdo 31 mars të vitit pasues,
- (18) Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte-veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat,
- (19) Të identifikojë dhe të mbaj shënime për amvisëritë që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat shënime (apo regjistra) përmbajnë të dhëna për përdoruesit e shërbimeve, adresën si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen rregullisht nga ana e komunës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike përkatësisht sektori për menagjimin e mbeturinave

(20) Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme, sipas nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, ky shërbim do të bëhet pa pagesë nga komuna në periudhat;

a) Java e parë e muajit maj [aksion pranveror] dhe

b) Java e parë muajit nëntor [aksion vjeshtor].

#### **Neni 6**

#### **LLOJET E MBETURINAVE**

1. Llojet e mbeturinave sipas kësaj rregulloreje janë:

1.1. Mbeturinat komunale;

1.2. Mbeturinat komerciale;

1.3. Mbeturinat industriale;

1.4. Mbeturinat medicinale.

2. Mbeturinat nga paragrafi 1. të këtij neni 6 , varësisht nga ekspozimi i rrezikshmërisë janë:

2.1. Mbeturinat inerte;

2.2. Mbeturinat e parrezikshme;

2.3. Mbeturinat e rrezikshme.

#### **Neni 7**

#### **SISTEMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE**

1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe me këtë Rregullore.

2. Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave bëhet nga operatori i paisur me leje përkatëse mjedisore. Mbeturinat grumbullohen nga amvisëritë, institucionet, bizneset, hotelet, restorantet dhe hapësirat publike.

3. Komuna përmes komisionit përkatës bënë përzgjedhjen dhe caktimin e vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimin e hapësirave për ndërtim të qendrave të mëdha për grumbullim. Pikat grumbulluese caktohen sipas planit për menaxhimin e mbeturinave.

4. Menaxhimi i mirë i mbeturinave nënkupton: mbulueshmëri me shërbim në tërë hapësirën komunale, shërbim të rregullt dhe cilësor.

5. Ngritja e vetëdijesimit publik që ka për objektive ngritjen e vetëdijes shoqërore për menaxhimin e mbeturinave, puna me komunitet, rinin, nxënësit dhe të gjitha palët e interesit, duke e rritur kënaqshmërinë e qytetarëve.

6. Të gjitha institucionet edukativo-arsimore të cilat funksionojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë nxënësit-studentët në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të trajtimit të mbeturinave.

#### Neni 8

### MBETURINAT KOMUNALE NGA NDERTIMI DHE RRENIMI I OBJEKTEVE NDERTIMORE

8.1 Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo rrënimit të objekteve, personat fizik dhe juridik duhet ti largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat të cilat i krijojnë.

8.2 Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi duhet të hidhen në deponitë legale të cilat përcaktohen me vendim ligjor nga Kuvendi Komunal i Malishevës.

8.3 Transportimi i këtyre mbeturinave, bëhet nga vetë prodhuesit ose ndërmarrjet për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në vend deponit e caktuara nga organi komunal.

8.4 Secili prodhues i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit obligohet të veproj në përkujdesje mjedisore, duke vepruar sipas Ligjit Nr. 04/L-60 për mbeturina, Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina, Udhëzimi Administrativ të MMPH Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit të objekteve ndërtimore dhe Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Malishevës.

8.5 Të gjithë operatorët publik dhe privat në transportimin e mbeturinave, trajtimin dhe përpunimin, si dhe operatorët në deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit duhet



të jenë të pajisur me leje përkatëse sipas Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060 dhe akteve nënligjor të Ministrisë.

**8.6** Dorëzuesit e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit në deponin legale për këto mbeturina, duhet të paguajn tarifën që përcaktohet nga Komuna e Malishevës.

#### **Neni 9**

#### **KATEGORIZIMI I GJENERUESVE TË MBETURINAVE**

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

**1. Konsumatorët e amvisërive:**

- i. Të shërbyer sipas shërbimit derë me derë,
- ii. Të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët publik.

**2. Konsumatorët komercialë/ industrial:**

- i. Dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese,
- ii. Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale , me kosto të ulët të shërbimit,
- iii. Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale, me kosto të lartë të shërbimit,

**3. Institucionet:**

- i. Konsumatorët e vegjël institucional,
- ii. Konsumatorët e mesëm dhe të mëdhenj institucionale,

#### **Neni 10**

#### **TË DREJTAT E GJENERUESVE TË MBETURINAVE**

**1.** Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,

**2.** Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.

**Neni 11****OBLIGIMET E GJENERUESVE TË MBETURINAVE**

1. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të taksës/tarifës së miratuar nga Komuna.
2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve në databazën përkatëse për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
3. Gjeneruesit e mbeturinave, duhet ti mundësojnë qasje operatorit në vendin e dorëzimit të mbeturinave.
4. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen:
  - a. Amvisëritë të cilave ju shërbehet derë me derë , mbeturinat duhet ti ndajnë dhe ti vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
  - b. Në banimet kolektive ku shërbimi bëhet në pika grumbulluese me kontejner, mbeturinat duhet ti ndajnë dhe ti vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
5. Gjeneruesit e mbeturinave të veçanta si: spitalet, ambulancat dhe objektet e tjera për shërbime mjekësore, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve, me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera.
6. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre ti hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme ti ndajnë dhe ti dorëzojnë në pikat mbledhëse apo vendet e caktuara.
7. Çdo gjenerues obligohet që ti largojë mbeturinat që krijohen gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, nga hapësirat ose vendet publike në lokacionet e caktuara nga komuna.
8. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të MM-së.
9. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme).
10. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

11. Çdo gjenerues i mbeturinave është i obliguar që të paraqes ndryshimin e të dhënave ( si p.sh. shitja e pronës, trashëgimia, dëshmitë dhe dokumentet tjera të përditësuara).

12. Shërbimet e veçanta, (largimi i mbeturinave të vëllimshme, dhe mbeturinave të tjera që nuk largohen gjatë shërbimit të rregullt dhe shërbimeve sipas nenit 5 pika 20), bëhen me pagesë, sipas parimit " NDOTËSI PAGUAN", në marrëveshje me kompaninë përgjegjëse..

13. Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme janë të obliguar që ta mbajnë të pastër hapësirën para objektit dhe përreth tyre.

#### Neni 12

#### BAZA E TË DHËNAVE DHE REGJISTRIMI I GJENERUESVE TË MBETURINAVE KOMUNALE

1. Komuna duhet të ketë listën e plotë të amvisërive për Komunën e Malishevës, të cilat marrin shërbim të rregullt të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave në programin e menaxhimit të mbeturinave.
2. Komuna e Malishevës Drejtoria e Shërbimeve Publike-Sektori i menaxhimit të mbeturinave do të krijoj bazën e të dhënave për ekonomi familjare që gjenerojnë mbeturina komunale në territorin e kësaj komune, konform Ligji Nr.06/L-082- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.
3. Baza e të dhënave do të regjistroj të dhënat personale te gjeneruesve, përcaktimin e llojit te mbeturinave nga gjeneruesit, kategorizimin e gjeneruesve, shumën e faturimit të tarifës dhe shumën e inkasimit të tarifës për grumbullimin e mbeturinave, me qëllim të interesit publik për implementimin e planit për menaxhimin efikas të mbeturinave komunale.
4. Përgjegjësi e menaxhimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave i takon Komunës së Malisheves - Drejtoria e Shërbimeve Publike-Sektori i menaxhimit të mbeturinave.
5. Gjeneruesit të cilët nuk janë në listën e SMM, janë të obliguar të regjistrohen.
6. Ne rastet kur gjeneruesi i ri, vendoset në objekt të ri, atëherë duhet të paraqet:
  - a) Dokumentin identifikues;
  - b) Dëshmi njehsorin e rrymës elektrike;

c) Dëshmi mbi regjistrimin e objektit në tatimin në pronë

d) Dëshmi e pagesës së faturës për mbeturina në adresën ku ka banuar më parë.

e) Kontratën e shitblerjes, nëse banesa apo objekti i banimit është blerë. Në këtë rast, shitësi i banesës do të ketë kartelën e njëjtë të klientit por me adresë të re në regjistrin e SMM. Të dyja palët, shitësi dhe blerësi duhet të kenë të paguar borxhin paraprak për mbeturina në tërësi.

7. Kur gjeneruesit posedojnë dy apo më shumë fatura të taksës për mbeturina, për objekte banimi aktiv, duhet të lajmërohen para organit komunal, respektivisht SMM për kategorizimin e ngarkesës së faturës.

8. Sipas paragrafit 4 të këtij neni, kategorizimi në ngarkesë të faturës nënkupton:

a. Kategoria e parë: amvisëritë rezidente ( vendbanim i përhershëm):

b. Kategoria e dytë: amvisëritë jo rezidente (amvisëritë me vendbanim të përkohshëm, që jetojnë jashtë territorit të Komunës së Malishevës, të dëshmuar me kartelën vjetore të hargjimeve të energjisë elektrike:

c. Kategoria e tretë: amvisëritë pasive (shtëpitë apo objektet e banimit të cilat janë të pabanuara por që pranojnë faturë për mbeturina), duhet të dëshmojnë me kartelën vjetore të hargjimeve të energjisë elektrike;

d. Kategoria e katërt: amvisëritë të tjera që nuk përfshihen në kategoritë më lartë.

9. Çdo gjenerues që banon me qira, është i obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emër të vet dhe duhet të regjistrohet në bazë të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar (qiradhënësi dhe qiramarrësi për banim)

10. Gjeneruesit që kanë më shumë se një faturë për të njëjtën amvisëri, anulohen / fshihen faturat nga baza e regjistrave për menaxhimin e mbeturinave nëse ofrojnë dëshmi të mjaftueshme.

**Neni 13**

**TAKSA PËR MBETURINA**

1. Taksa për mbeturina faturohet dhe inkasohet nga Komuna.
2. Faturimi i taksës për mbeturina bëhet në bazë vjetore, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave deri me 31 mars të vitit kalendarik.
3. Komuna i cakton taksat për mbeturina, varësisht nga lloji i tyre.
4. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave. Gjeneruesi mund ta bëjë pagesën edhe në këste 3 mujore si me poshtë:
  - a. Kësti i parë, Janar-Mars,
  - b. Kësti i dytë, Prill-Qershor,
  - c. Kësti i tretë, Korrik-Shtator,
  - d. Kësti i katërt, Tetor-Dhjetor.
5. Pagesa e taksës për mbeturina bëhet në institucionet financiare për pagesa të përcaktuara me ligj.
6. Detajet e mëtejshëm për taksat komunale sipas kategorive gjenden në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

**Neni 14**

**TARIFA PËR AMVISËRITË**

1. Amvisëritë rezidente janë të obliguara të paguajnë tarifën për taksë për mbeturina sipas kësaj rregulloreje.
2. Amvisëritë jo rezidente me anë të kartelës financiare të shpenzimeve mujore të energjisë elektrike për vitin kalendarik, do të ngarkohen sipas formulës:

$$M \times T + (12-M) \times t$$

M= numri i muajve të vitit me mbi 15 € shpenzime elektrike (maksimum 6 muaj),

T = tarifa mujore (€),

12 = muajt në vitin kalendarik,

t = tarifa mujore me më pak se 15 € shpenzime elektrike (€)= 1€

Shembull: M =3, T= 5.5, t = 1€, atëherë  $3 \times 5.5€ + (12-3) \times 1€ = 16,5 + 9 = 25.5 €$

3. Nëse çmimi i energjisë elektrike do të ndryshojë, do të ndryshoj edhe shuma maksimale (15€) sipas përqindjes së ndryshimit.

#### Neni 15

#### OBLIGIMI I PAGESËS SË TARIFËS PËR MBETURINA

1. Të gjithë gjeneruesit të cilët marrin shërbim mbi grumbullimin e mbeturinave dhe janë të regjistruar në bazën e të dhënave, detyrohen të paguaj tarifën. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 2 këste të njëpasnjëshme (janar-mars dhe prill-qershor), ndaj secilit gjenerues do të iniciohet procedurë e përparimit tek përparuesit privat për pagesë të detyrueshme të borxhit.
2. Shkalla e tarifës do të rishikohet çdo dy vjet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i menaxhimit të mbeturinave, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj.
3. Taksa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për të gjitha kategoritë e gjenerueseve të mbeturinave (amvisëritë, bizneset, institucionet publike dhe bizneset e shkallës së lartë), përcaktohet sipas tabelës në shtojcën i të kësaj Rregulloreje.
4. Kur Kuvendi Komunal aprovon shkallën e përshtatshme të inkasimit të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

5. Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave që iu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

#### **Neni 16**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E OPERATORËVE TË KONTRAKTUAR PËR SHËRBIMIN E MBETURINAVE**

1. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj konform obligimeve ligjore, sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.
2. Operatori i kontraktuar është i obliguar që të raportoj për çdo muaj për shërbimet kontraktuese, si dhe ta dorëzoj raportin vjetor ku prezantohet sasia e mbeturinave të dorëzuara në deponi deri në fund të muajit shkurt të çdo viti kalendarik në drejtorinë e shërbimeve publike përkatësisht në sektorin e menaxhimit të mbeturinave (SMM).

#### **Neni 17**

#### **VEPRIMET E NDALUARA**

Më këtë rregullore ndalohen veprimet si më poshtë:

1. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;
2. Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë;
3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave etj.);
4. Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
5. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

6. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, dhe në vende të tjera publike);
7. Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;
8. Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, ose në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
9. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
10. Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale"
11. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
12. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
13. Derrdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
14. Personat duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
15. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër.
16. Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.



## Neni 18

## ZBATIMI I RREGULLORES DHE DISPOZITAT NDËSHKUESE

1. Çdo person fizik apo juridik i cili shkel dispozitat e neneve të kësaj Rregulloreje do të shkaktoj kundërvajtje dhe do të ndëshkohet sipas neneve 71, 72, dhe 73 të Ligjit për Mbeturina 04/L-060, LIGJI NR. 08/L-071L për Ndryshimin dhe Plotësimin E Ligjit Nr.04/L-060 Për Mbeturina nenit 49, Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit 2009/ 03-L025, Udhëzimeve Administrative për ndëshkimet dhe gjobat mandatore.
2. Ndaj gjeneruesit te mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina dhe i cili nuk i përmbahet rregullore, do të iniciohet procedurë ligjore përmbaruese sipas ligjit në fuqi.
3. Për shkelësit e dispozitave të kësaj Rregulloreje, për veprimet e ndaluara sipas nenit 16, (par. 1-16) inspektori i mjedisit, inspektori komunal, zyrtari policor, shqiptojnë gjobë mandatore sipas ligjeve në fuqi. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit, dhe zyrtarët e tjerë të autorizuar nga ana e Komunës.
4. Shumat e gjobave të cilat i shqipton inspektori i mjedisit janë të përcaktuara me akt nënligjor të ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kundër vendimit të inspektorit të mjedisit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin për procedurën Administrative.
5. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe njësitë përkatëse të Administratës komunale.

**Neni 19**

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

1. Në te gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjeve përkatëse në fuqi.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Malishevë, me propozimet e arsyetuara nga propozuesi

**Neni 20**

**HYRJA NË FUQI**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Malishevë, kjo rregullore hynë ne fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË**



02/Nr. \_\_\_\_\_


Datë: \_\_\_\_\_





## SHTOJCË:

TABELA 1. Kategorizimi i konsumatorëve për taksat komunale

 <b>AMVISËRITË</b>	Tarifa Euro/Muaj
 <b>AMVISËRITË URBANE DHE RURALE</b>	<b>5.50 €</b>

 <b>DYQANET E VOGLA ARTIZANALE DHE SHËRBYESE</b>	Tarifa Euro/Muaj Lloji i shërbimit 1/7 në javë
Kioska, kafe pjekëse, shitore, shitës të CD-ve dhe kasetave, argjendari, orëtarë, agjenci turistike, avokatura, videolojrat, video klub, internet kafe, rrobaqepës, këpucëtarë, dyqan fotografish, pastrim kimik, kozmetika, optika, gurëgdhendës, saraç-mbathtarë, zyra e inkasimit, përfaqësi të shoqatave, shitore suvenirësh, këmbimore, librari, objekte religjioze, veprimtari tjera të ngjashme.	<b>6.50 €</b>

 <b>SUBJEKTET E MESME DHE ATO TË MËDHA KOMERCIALE/ INDUSTRIALE ME KOSTO TË ULËT TË SHËRBITIMIT</b>	Tarifa Euro/Muaj Lloji i shërbimit 1/7 në javë
Autolarje, autoparking, kurse të gjuhëve dhe IT, pompa të benzinës, zyre postare, pemëshitës dhe minimarkete, auto pjesë, butiqe, shitore tekstili, hektari, shitore sanitarie, mobileri, barnatore, bodrume të pijeve, zyre të partive politike, byrektore, ëmbëltore, floktar (stilst), veprimtari tjera të ngjashme	<b>8.00 €</b>

 <b>SUBJEKTET E MËDHA KOMERCIALE/ INDUSTRIALE DHE INSTITUCIONE TE SHËRBYER ME KONTRATA TË VEÇANTA</b>	<b>Tarifa Euro/Muaj Lloji i shërbimit -Zbrazje 1.1m3 - 7.1.m3</b>
Poliklinikat dhe spitalet private, selitë( telekom, sigurime bankare), sallone të mëdha të sanitarisë dhe qeramikës, sallone të mëdha të mobilieve, shtëpi botuese, shtypshkronjat, qendra tregtare, restaurantet, hotelet ( mbi 20 dhoma), pompa benzine me restaurant, supermarketete të mëdha, veprimtari tjera të ngjashme	<b>12.00 – 45.00 €</b>